

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“MM TRADING” SH.P.K.**

Sot më datë, 29.04.2020, pala e mëposhtme,

- **Z. Martin Mane**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 11.07.1997, me banim në Kompleksion Rezidencial Rolling Hills, Farkë, Tiranë, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasapotës nr. BR2789989.

në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar “**MM Trading**” Sh.p.k. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkalidhur këtij akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

**Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**MM Trading**” Sh.p.k” (këtej e tutje referuar edhe si “**Shoqëria**”).
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 - Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga “Papa Gjon Pali II”, Ndërtesa Nr.12, Kati 11-të, Zyra nr.1206, Njësia bashkiake nr.2, Tiranë.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

- 3.1. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2. Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 4 – Objekti**

- 4.1 Objekti i aktivitetit ekonomik të Shoqërisë është (i) ndërmjetësimi në shitje-blerjen e shërbimeve, (ii) ndërmjetësimi në shitje-blerjen e produkteve dhe mallrave të cilatdo lloji qofshin si p.sh. industrial ose jo, ushqimore ose jo ushqimore, ndërtimi, elektrike, elektronike, elktroshtëpiake, mjekësore etj, (iii) ndërmjetësimi në shitje-blerjen e pasurive të paluajtshme, (iv) shitje-blerje me shumicë e mallrash dhe produkteve, (v) import-eksporti i produkteve dhe mallrave të cilatdo lloji, (vi) dhënia e shërbimeve të konsulencës financiare, si dhe ushtrimi i të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me ose plotësojnë, direkt apo indirekt, aktivitetin e mësipërm.

- 4.2 Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të përfitojë, direkt apo indirekt, pjesëmarrje në shoqëri, ndërmarrje, agjenci dhe sipërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë një objekt aktiviteti të ndryshëm.
- 4.3 Gjithashtu, për të realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj transaksioni lidhur me shitblerjen e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qeraje apo hipotekimi që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim me objektin e Shoqërisë.

#### **Neni 5 – Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1000 LEK (një mijë lekë), i përbërë nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 1000 LEK (një mijë lekë) secila.
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
- Z. Martin Mane, ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 1000 LEK (një mijë lekë).
- 5.3 Duke u bazuar në kontributet e mësipërme:
- Z. Martin Mane zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (një qind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Article 6 – Transferimi i Kuotave**

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të Statutit.

#### **Article 7 – Administratori/ët**

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 7.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale (“*ad negotia*”) për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 7.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:
- Z. Martin Mane, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 11.07.1997, me banim në Kompleksion Rezidencial Rrolling Hills, Farkë, Tiranë, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasapotës nr. BR2789989.


**Neni 8 – Dispozita të Fundit**

- 8.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

\* \* \*

**NË DËSHMI TË SA MË SIPËR**, Pala deklaron se ky Akti Themelimi dhe Statuti bashkangjitur si Shtojca A, është në përputhje me vullnetin e saj dhe për këtë arsye e nënshkruan atë në datën e sipërshtënuar, me vullnet të plotë dhe të lirë.

**ORTAK I VETËM**

  
Z. Martin Mane